



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTAT E AUTORIT

Nr. .... Prot.

Tiranë, datë / / 2014

**Lënda:** Informacion mbi Aktivitetin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit për periudhën Prill –Nëntor 2014

**Drejtuar :**

**Znj. MIRELA KUMBARO (FURXHI)**

**MINISTËR**

**MINISTRIA E KULTURËS**

**Për Dijeni:**

**Z. ALBI ALLA, DREJTOR**

**DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE FONDEVE IPA**

E nderuar Znj. Ministre,

Më lejoni t'Ju informoj mbi aktivitetin dhe punën e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit që nga muaji Prill 2014 e deri më sot, në mënyrë të detajuar mbi punën sektoriale të këtij institucioni.

**I. SEKTORI I REGJISTRIM-ÇERTIFIKIMIT DHE ANKIMEVE RELATON KËTË PËRMBUSHJE TË DETYRAVE NË HARKUN KOHOR TË LARTPËRMENDUR:**

**1. Regjistrim-çertifikim e drejtë autori: 53 (pesëdhjetë e tre) çertifikime e drejtë autori.**

Ndarja sipas kategorive të veprave të regjistruara dhe çertifikuara.

- a) Kategoria 7/A - 14 (katërbëdhjetë) çertifikata
- b) Kategoria 7/B – 22 (njëzetë e dy) çertifikata.
- c) Kategoria 7/C – 4 (katër) çertifikata

- d) Kategoria 7/D – 5 (pese) çertifikata.
- e) Kategoria 7/E – 2 (dy) çertifikata.
- f) Kategoria 7/Ë – 1 (një) çertifikatë
- g) Kategoria 8/B – 5 (pesë) çertifikata.

## **2. Regjistrim-çertifikim kalim të drejtash: 13 (trembëdhjetë) çertifikime kalim të drejtash.**

Ndarja sipas kategorive të veprave të regjistruara-çertifikuara kalim të drejtash.

- a) Kategoria 7/A – 13 (dymbëdhjetë) çertifikata

## **3. Regjistrim kontrate: 4 (katër) regjistrime kontratash.**

Duke marrë parasysh shqetësimet e shumë autorëve dhe interpretuesve të veprave të ndryshme letrare, artistike, shkencore, sektori i regjistrim-çertifikimit dhe ankimit ka dhënë të gjithë ndihmesën e duhur duke organizuar takime me to, për ti orientuar drejtë mbi të drejtat dhe detyrimet që ato kanë mbi veprat e tyre në bazë të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

Gjithashtu subjekteve juridike që kanë si objekt veprimtarie prodhuese, tregtare apo çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, artistike ose shkencore, u është dhënë ndihma e nevojshme nga ana e ZSHDA për problemet që ato hasin gjatë aktivitetit të tyre tregëtar, në raport me të drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera, të lidhura me të.

## **4. Procedimet administrative**

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar **148 (njëqind e dyzet e tetë) procedime administrative**, nga të cilat:

### **86 procedime administrative, po shqyrtohen nga Sektori i Rregjistrim-Certifikimit & Ankimit.**

Po zhvillohet procedimi administrativ për këto subjekte, duke zbatuar procedurën e përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative.

- SRÇA i ka dërguar **7 kërkesa** për korrigjimin e të metave palës ankimuese, pasi ka vënë re parregullsi në kërkesat ankimore. (*Ankimues Agjencia e Administrimit Kolektiv e te Drejtave te Artisteve Interpretues/Ekzekutues (AKDIE) kundër OSHMA-ritransmetues kabllorë*)

- **1 procedim administrativ** është pushuar, pasi nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se pala e ankimuar nuk mund të legjitimohej për të marrë pjesë në procedimin administrativ.

- **5 procedime administrative kanë përfunduar në favor të palës ankimuese.**

Pasi është zhvilluar procedura hetimore, janë administruar provat, dëgjuar pretendimet dhe shpjegimet e pa

lëve rreth çështjes, SRCA ka vendosur përfundimin e hetimit administrativ në favor të palës ankimuese.

· **2 procedime administrative janë zgjidhur me mirëkuptim mes palëve.**

SRCA pasi ka zhvilluar seancat dëgjimore, i ka shpjeguar të dyja palët në proces të gjithë hapat proceduriale që do të ndërmerren në procesin administrativ dhe veprime të tjera ligjore që palët mund të zgjedhin të ndjekin.

Pas këtyre bisedimeve palët e kanë zgjidhur me mirëkuptim konfliktin objekt shqyrtimi. (*Ankimues Agjencia e administrimit kolektiv FMAA vs Televizionit ABC News; AMP vs Tv Kabllor Ir-Gen*)

· **54 procedime administrative janë pushuar sipas kërkesës së palës ankimuese.**

Gjatë procesit administrativ pala ankimuese ka kërkuar pushimin e procedimit pasi nuk kanë mundur të provojnë pretendimet e tyre (neni 82 e në vijim i Kodi të Procedurës Administrative) ose kanë zgjidhur çështjen me mirëkuptim.

(*Ankimues Agjencia e Administrimit Kolektiv e te Drejtave te Artisteve Interpretues/Ekzekutues (AKDIE) kundër OSHMA radio dhe kanllorëve; Nuri Çumani vs Gazeta "Shekulli"; Nuri Çumani vs "Top Channel"*)

· **Në 1 (një) procedim administrativ pala ankimuese nuk është paraqitur në seancën dëgjimore, duke braktisur procedimin administrativ.** (*Nuri Çumani vs Gazeta "Paloma"*)

· **Problematika e ndeshur gjatë shqyrtimit të ankesave, është ajo që ka shoqëruar të gjitha procedimet administrative të zhvilluara deri më tani, si:**

- o Paraqitja e disa kërkesave ankimore të paplota, pra jo në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin e Procedurave Administrative;
- o Mosparaqitja e provave që në seancat e para nga pala ankimuese, për të vërtetuar cënimin e së drejtës së autorit/të drejtave të tjera të lidhura me të, e cila sjell zgjatjen e procedimit;
- o Mosparaqitja në seancë administrative e palës së ankimuar e cila sjell zgjatjen e procesit administrativ.

**5. Proceset gjyqësore:**

Spektori i RÇA ka përfaqësuar ZSHDA-në në 7 (shtatë) procese gjyqësore, si më mëposhtë:

· **Në 3 (tre) procese gjyqësore ku ZSHDA ka qënë palë e tretë, të cilat po shqyrtohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

· **Në 4 (tetë) procese gjyqësore ZSHDA ka qënë në në pozicionin procedural të paditurit apo paditësit, si më poshtë:**

1 (një) proces gjyqësor ka përfunduar në favor të ZSHDA-së.

1 (një) proces gjyqësor ka përfunduar në favor të paditësit.

1 (një) proces gjyqësor është pushuar pasi pala paditëse nuk u paraqit në seancën gjyqësore.

Në 1 (një) proces gjyqësor, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur dërgimin e akteve pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

## 6. Urdhëra Ekzekutimi

Pas përfundimit të afateve ligjore dhe kthimin e fletë gjobave të vendosura nga inspektorët e ZSHDA-së në titull ekzekutiv, ZSHDA ka kërkuar nga organet gjyqësore kompetente (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës) lëshimin e “Urdhërit të Ekzekutimit” për masat administrative.

SRÇA ka kërkuar në **17 raste** lëshimin e "Urdhërit të Ekzekutimit", nga të cilat vetëm **4 janë** refuzuar. Kundër 4 vendimeve të refuzimit është bërë ankim në Gjykatën e Administrative të Apelit.

## 7. Ankime administrative ndaj masave administrative

SRÇA ka shqyrtuar **12 kërkesa ankimore** mbi masat administrative të vendosura nga inspektorët e ZSHDA-së., nga të cilat:

**11 kërkesa ankimore** janë rrëzuar, duke lënë kështu në fuqi masën administrative.

**1 kërkesë ankimore** është pranuar.

## II. SEKTORI I INSPEKTIMIT / MONITORIMIT DHE ZRDA-VE

Gjatë monitorimit dhe inspektimit për periudhën Prill-Nëntor 2014 ndaj subjekteve tregtare, të cilat në ushtrim të aktivitetit të tyre janë përdorues të veprave që mbrohen nga LDA, është bërë konstatimi i përdorimit të këtyre veprave në ambjentin tregëtar nëpërmjet proces-verbaleve përkatës nga inspektorët e ZSHDA në qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier dhe Shkodër, ku janë konstatuar probleme të ndryshme.

Janë Monitoruar/Inspektuar gjatë kësaj periudhe **443 subjekteve të kategorive** si me poshtë:

1. Bar-Kafe
2. Videoteka
3. Shërbime Telefonike (Call Center)
4. Pika Shitje Kompjuterash
5. Librari
6. Fotokopje
7. Televizione
8. Radio
9. Kabllorë
10. Hotele

Nga këto **335 subjekte janë monitoruar dhe 108 subjekte janë inspektuar**.

Lidhur me kategoritë e mësipërme të inspektuara janë marrë masa administrative (gjobë) me gjobë në **24 subjekte** prej tyre, pjesës tjetër të subjekteve i`u janë lënë detyra dhe do të inspektohen në vijimësi sipas planit të punës të përcaktuar.

Në momentin e monitorimit, subjekteve i`u është bërë me dije detyrimi që kanë kundrejt legjislacionit në fuqi për të Drejtën e Autorit duke qënë se janë përdorues/shfrytëzues të veprave artistike, letrare dhe shkencore.

Në fund të muajit shtator 2014 u zhvillua aksioni “**Mërkuri i Bardhë**” nga INTERPOLI në bashkëpunim me Drejtorinë e Krimit Ekonomik të të gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor, si aksione të përbashkëta për konfiskimin e mallrave të piratuara. Ky aksion u kërkuar dhe nga Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit për të kontrolluar pjesën e produktit intelektual në RSH. Janë inspektuar kryesisht subjekte si Call Centre, Pika shitjesh kompjuterike, Dyqane CD/DVD, Operatore Kabllorë dhe TV. Janë konfiskuar rreth 3600 CD/DVD dhe janë bllokuar rreth 500 PC. Aksioni në bashkëpunim të ngushtë me ZSHDA dhe Drejtorinë e Krimit Ekonomik rezultoi mjaft i suksesshem dhe ky bashkëpunim do të vijojë dhe më pas me plane pune të përbashkëta.

### **Në lidhje me çështjen Sig Ship!**

Drejtoria e Krimit Ekonomik në bashkëpunim me Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit arrestoi Z. Ilir Muzhaqi, personi i cili ka drejtuar Subjektin” SIG – SHIP” për vite me rradhë.

Ky subjekt që nga viti 2008 është regjistruar në QKR dhe ushtronte veprimtari fitimprurëse në fushën e mbledhjes të të ardhurave që vijnë nga përdorimi i të drejtave të autorit dhe i të drejtave të lidhura, duke shkëlur Ligjin 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të”.

## **INFORMACION MBI AKTIVITETET E KRYERA DHE ATO QË PRESIN TË JETËZOHEN**

Çdo fillim viti kalendarik ZSHDA përgatit një plan aktivitetesh për t`u mbështetur nga WIPO dhe nga KE/TAIEX në kuadër të bashkëpunimit me këto organizma por dhe me donatorë të tjerë.

Një nga projektet me të rëndësishme që po e listojmë të parin është **GDA SYSTEM**.

Në fillim të vitit 2013 është aplikuar pranë Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale për disa aktivitete duke përfshirë këtu dhe një projekt, (ku ZSHDA është përzgjedhur dhe e ka fituar) **GDA SYSTEM**, i cili është një risi e zhvilluar nga WIPO dhe ka si qëllim përmirësimin e efikasitetit të proceseve të regjistrimit vullnetar të të drejtës së autorit, e cila kryhet nga një zyrë e të drejtës së autorit nëpërmjet një procesi automatik IT. Ky projekt do sjellë risi pasi do bëjë të mundur aplikimin për Regjistrimin e të drejtës së Autorit në formën ONLINE, si edhe të çdo kontrate kalim të drejtash, gjithashtu implementimi i tij, bën të mundur që për çdo rast aplikimi ZSHDA ka mundësi të bëjë verifikimin online në Bazën e të dhënave të WIPO, mbi çdo aplikim.

Jemi duke punuar për ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për të bërë të mundur jetëzimin e këtij projekti, duke reduktuar punën manuale dhe dosjet e shumta sipas praktikave.

*Referuar specifikimeve teknike që kërkonte ky projekt për tu zbatuar, nevojiteshin disa parametra specifikë. Shpresojmë në miratimin e këtij projekti nga donatorët ku kemi aplikuar.*

**Në 26 Prill 2014**, në kuadër të Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale, ashtu siç jeni njoftuar në mënyrë të vazhdueshme mbi këtë event, u zhvillua faza përmblylëse e Konkursit kombëtar **“Të mbrojmë Pronësinë Intelektuale – Të edukojmë Gjeneratën që po rritet”**, një aktivitet ky u përfshinë mbi 200 shkolla 9-vjecare dhe të mesme dhe mbi 1000 nxënës. Pritshmëritë ishin tejet maksimale dhe impakti që përcolli kjo fushe e re dhe pothuajse e panjohur për brezin që rritet ishte pozitive. Aktivitet ky, që u mbështet nga shumë donatorë në mënyrë modeste si dhe Dhoma Amerikane e Tregtisë.

**Në 12-14 maj 2014** u organizua një vizitë studimore në Suedi në Zyrën Suedeze të Regjistrimit dhe të Patentave.

**Në qershor 24-26, 2014**, po në kuadër të shërbimeve që ofron KE/TAIEX si dhe INTERPOL, Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit është përfituese e një workshop-i rajonal **“Mbi zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura për sistemin e drejtësisë si dhe institucionet e tjera zbatuese – krimi i të drejtave të pronësisë intelektuale”**. Ky është një nga aktivitetet më të mëdha që ZSHDA organizon duke mbledhur së bashku institucionet shtetërore zbatuese të PI nga Vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe shtete të tjera të Rajonit me një eksperiencë për tu konsideruar si Sllovenia, Bulgaria dhe Kroacia.

**Po në tetor 2014, punonjës të ZSHDA u trajnuan nga WIPO Academy sipas kurseve të trajnimit intensive 2- javore**, që kjo e fundit ofron për specialistët e zyrave të të drejtës së autorit dhe pikërisht në Finlandë, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të këtij shteti.

- Një nga projektet që ZSHDA do të kërkojë dhe asistencën e ekspertëve të KE por dhe mbështetjen e Ministrit të Kulturës, është ***Krijimi i një Strategjie të komunikimit dhe ndërgjegjësimit të Pronësisë Intelektuale***. ZSHDA e shikon si thelbësore miratimin e një Strategjie të tillë, pasi mungesa e informimit dhe e ndërgjegjësimit është në nivele të larta. Edukimi, ndërgjegjësimi i brezave, mbetet një nga mjetet dhe mënyrat më efikase për krijimin e një mentaliteti ndryshe, që krijimtaria e mendjes njerëzore duhet respektuar. Programet e edukimit dhe të ndërgjegjësimit publik duhet të jenë pjesë integrale e kësaj Strategjie. ZSHDA u është drejtuar Ju për fillimin e procedurave dhe rrugës që duhet të ndiqet që kjo Strategji të miratohet.
- ***Futja në Kurikulën shkollore brenda vitit 2015***, të koncepteve të të drejtës së Autorit, është një nga prioritetet e ZSHDA-së. Për këtë kërkojmë ndërhyrjen dhe bashkëpunimin e Ministrisë së Kulturës. IZHA është në procesin e rishikimit të kurikulave shkollore. ZSHDA ka kontaktuar më IZHA dhe ka vënë në dijeni Ministrinë e Arsimit për detyrimin që buron nga Strategjia Kombëtare e Zbatimit të të drejtave të pronësisë Intelektuale. Janë duke u bërë të gjitha përpjekjet nga ana e ZSHDA-së për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me IZHA në mënyrë që kjo fushë “Pronësia Intelektuale” të jetë pjesë e kurikulës shkollore, si një nga mënyrat me efikase në edukimin e brezave që rriten.
- ***Është marrë kontakt me Trupat Diplomatike*** në Tiranë, konkretisht me Ambasadën Turke, Daneze, Gjermane, Hollandeze dhe Kineze për vendosjen e urave të bashkëpunimit dhe përfshirjen në projekte të përbashkëta në fushën e të drejtës së autorit por dhe krijimin e kontakteve me zyrat homologe të ambasadave respektive. Këto institucione kanë përkrahur idenë e bashkëpunimit dhe të forcimit të marrëdhënieve reciproke por dhe të trajnimeve të ndryshme dhe dhënien e ekspertizës për stafin e ZSHDA-së.

- Është duke u punuar në mënyrë të vazhdueshme nga ana e stafit të ZSHDA për *përmirësimin e imazhit* të këtij institucioni dhe ngritjen e tij në nivele të kënaqshme.
- Ka filluar *organizimi i takimi të gjerë dhe gjithëpërfshirës me Universitetet shtetërore publike dhe private dhe institucione të tjera arsimore*, për t'u bërë me dije detyrimet që u takojnë në bazë të legjislacionit në fuqi për të Drejtën e Autorit. Në këtë takim, që pritet të zhvillohet nga fundi i **Muajit Nëntor 2014** do të ketë të ftuar dhe nga Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit, shkolla e Magjistraturës, etj.
- Kërkojmë mbështetjen Tuaj për realizimin e *një Buletini informativ 2010-2014*, duke dhënë kështu një panoramë të përgjithshme për prioritetet e ZSHDA-së dhe veprimtarinë e saj deri më sot. Si rezultat i një buxheti të limituar e kemi të pamundur mbulimin e kostove të saj. *Kërkojmë mbështetjen Tuaj në këtë drejtim.*
- Janë në procedura përfundimi dhe nënshkrimi *dy memorandume* të rëndësishme me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). Pavarësisht marrëdhënieve bashkëpunuese që ZSHDA ka krijuar me institucionet që janë pjesë e zbatimit të të drejtave të autorit si AMA, AKEP, DPD, DPT, DPP, kërkojmë vëmendjen dhe bashkëpunimin Tuaj që të ndërhyri në forcimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve.

### ***STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZBATIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELLEKTUALE 2010-2015***

Masat dhe aktivitetet e parashikuara në PKZMSA (2012-2015), janë njëkohësisht pjesë e planit të veprimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intellektuale dhe Industriale, 2010-2015. Në kuadër të strategjisë, për fushën e pronësisë intelektuale, është projektuar një qasje më e gjerë ndër- institucionale. Ajo çka duhet të theksojmë është se vonesa e miratimit të Draft Ligjit për të Drejtën e Autorit ka sjellë mos-realizimin e detyrave të tjera të cilat janë të lidhura në mënyrë direkte me miratimin e Draft- ligjit.

Ndodhur në këto kushte ku ZSHDA është penguar në realizimin e detyrave të saj në përmbushje të misionit për të cilin është krijuar, sërish me mundësitë e saj ka arritur të përmbushë suksesshëm një pjesë të konsiderueshme të detyrave të veta që i burojnë nga Ligji në fuqi.

Në mbledhjet e grupit ndër-institucional të punës për monitorimin e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Zbatimit të të Drejtave të Pronësisë Intellektuale (2010-2015) u diskutua mbi mos-realizimin e detyrave që lindin nga ky dokument. ***Miratimi i Draft Ligjit për të Drejtën e Autorit vazhdon të mbetet një prioritet i fushës së pronësisë intelektuale i cili duhet të miratohet pa vonesë, rekomandim ky dhe i ekspertëve të BE-së.***

Një iniciativë dhe bashkëpunim tjetër ka filluar me Agjencinë e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) e cila do të finalizohet së shpejti me nënshkrimin e një Memorandumi Bashkëpunimi ku secili nga institucionet do të ketë përgjegjësi të caktuara ca i takon faqeve të internetit me përmbajtje pa të drejtë autori. Në vijim të kësaj, në bazë të vendimit të ndërmjetëm Nr. 727/1 datë 11.09.2014 “Për bllokimin e faqeve elektronike”, ZSHDA në bashkëpunim me AKEP ***ka bllokuar faqe të caktuara elektronike (36 faqe) të cilat vendosin në dispozicion të publikut në mënyrë interaktive vepra të ndryshme kinematografike.***

Ky bashkëpunim do të vijojë deri në bllokimin e të gjitha faqeve elektronike të paautorizuara për të vënë në dispozicion të publikut vepra të caktuara kinematografike dhe/ose audiovizuale.

*E nderuar Znj. Ministre,*

*Duke Ju falenderuar dhe besuar fuqishëm në mbështetjen që na keni dhënë deri më sot, kërkojmë ndërhyrjen e autoritetit TUAJ në lidhje me aplikimin e Fonedeve IPA II 2014- 2020, që në prioritetet e Ministrisë së Kulturës, të renditet dhe “Forcimi i të drejtave të autorit dhe të Drejtave të Lidhura në Republikën e Shqipërisë” si i vetmi institucion varësie që ka detyrime të drejtpërdrejta në Marrëveshjen e Asociim – Stabilizimit, në nenin 73 të saj si dhe detyrime që burojnë nga dokumenta të tjerë strategjikë për t`u përmbushur, në mënyrë që Shqipëria të jetë vend anëtar me të drejta të plota në Bashkimin Europian.*

Duke besuar në vullnetin dhe mbështetjen Tuaj maksimale,

**EVIEN DAKO**

---

**DREJTOR**